



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHE

Nr. _____ Prot.

Lezhë, me _____._____.2021

Shtojca 12

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

21.10.2021

Drejtuar: LODI CONSTRUCTION SHPK me adrese: Rruga Kongresi i Permetit, nr. pasurie 2/1132+1-5, zona kadastrale 8591 me sipërfaqe 80.33 m², Shkoder

Procedura e prokurimit/lotit: E hapur/Pune

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-06862-09-30-2021**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Rrethimi dhe Sistemimi i Varrezave ne Njesite Administrative te Bashkise Lezhe” (Ne Fshatrat Ishull Lezhe “Lagjia e Hotelit”, Shengjin, Ishull Lezhe, Kakarriç, Balldren i vjeter, Rrile, Tale 1, Zejmen, Markatomaj, Gryke Manati, Vele, Troshan, Ungrej, Kashnjë, Krajen dhe Kallmet)

Kohëzgjatja e kontratës: 3 muaj nga data e nënshkrimit te kontrates

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- 1- Operatori Ekonomik “2 N” SH.P.K me Nuis L31615017L me oferte ekonomike 17,872,974 (shatëmbëdhjetë milion e tetqind e shtatëdhjetë e dy mijë e nentëqind e shtatëdhjetë e kater) lek pa TVSH.
- 2- Operatori Ekonomik “LODI CONSTRUCTION” SH.P.K me Nuis L77127002C me oferte ekonomike 23,321,720 (njetzet e tre milion e treqind e njetzete nje mijë e shtatëqind e njetzet) lek pa TVSH.
- 3- Operatori Ekonomik “PEPA GROUP” SH.P.K me Nuis L42215009L me oferte 19 540 220 (nëntëmbëdhjetë milion e pesëqind e dyzet mijë e dyqind e njetzet) lek pa TVSH.

4- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “SARDO” SH.P.K me Nuis K13120402W & “BEQIRI” SHPK, me Nuis J98624801V, me oferte ekonomike 20.936.810 (njezet million e nenteqind e tridhjetete gjashte mije e teteqind e dhjete) lek pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1- Operatori Ekonomik “2 N” SH.P.K me Nuis L31615017L, per arsyet e mëposhtme:

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE:

Nuk ploteson kriterin 2.3.8 te DST-se ne te cilin kerkohet qe Stafi kryesor ose mbeshtetes duhet te jete i certifikuar te pakten: - 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Per te permbushur kete kriter OE duhet te paraqese kontrate pune dhe certifikatat perkatese si dhe duhet të jetë ne listëpagesat e shoqerise të paktën për periudhën Qershor 2021 – Gusht 2021

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi fitues perpara dhenies se kontrates.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave, bazuar ne nenin 82 te ligjit nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, ku parashikohet se “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*”, ne nenin 26 te VKM-se 285 date 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet se “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*”, konstaton se per permbushjen e ketij kriteri operatoret ekonomike duhet te deklarojne ne Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, punonjesin i cili eshte i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Nga verifikimi ne SPE i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, te paraqitur nga operatori ekonomik “2 N” SHPK, rezulton se nuk eshe deklaruar emri i punonjesit te pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, duke mos permbushur kete kriter.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet

kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e **OE “2 N” SH.P.K.**, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “2N” SH.P.K, me Nuis L31615017L, *skualifikohet*.

Per sa me sipër oferta e dorëzuar nga OE “2 N” SH.P.K, skualifikohet.

2- Operatori Ekonomik “PEPA GROUP” SH.P.K me Nuis L42215009L, për arsyet e mëposhtme

Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE rezulton se OE:

Se pari, nuk plotëson kriterin 2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale: Sipas kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit (shtojcat), pasi shtojca numer 2, e paraqitur në SPE, nuk është në përputhje me formatin tip të miratuar dhe publikuar në DST.

Në formatin e paraqitur nga Operatori Ekonomik “PEPA GROUP” SHPK, mungojnë elementet e deklaramentit si më poshtë:

“Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë zërat në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës”.

KVO thekson se formati i shtojcave për këtë procedurë prokurimi është i miratuar me Vendimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 02, datë 09.06.2021 Për miratimin e dokumentave standarte të tenderit për Mallra, Pune, Shërbime për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” dhe është detyrim ligjor për autoritet kontraktore dhe operatorët ekonomikë për t’ju përmbajtur këtij formati.

Se dyti, nuk plotëson kriterin 2.3.7 në të cilin kërkohet:

Krahas stafit të mesiperm mbështetës duhet të ketë të punësuar edhe Punonjësit si më poshtë:

-Suvatues	- 2	Certifikate trajnimi ose Deshmi Profesionale
-Murator	- 2	Certifikate trajnimi ose Deshmi Profesionale
-Manovrator	- 1	Certifikate trajnimi ose Deshmi Profesionale
-Hekurkthyes	- 2	Certifikate trajnimi ose Deshmi Profesionale
-Shofer	- 3	Certifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Leje Drejtimi

Operatori ekonomik duhet te paraqes per stafin e mesiperm: Librezat e punes, kontratat individuale te punës, Certifikatat e trajnimeve/deshmite profesionale/Leje Drejtimi sipas shenimeve per cdo kategori te mesiperme dhe stafi i mesiperm te figuroje ne listepagesat e shoqerise per periudhen Qershor 2021 – Gusht 2021.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi fitues perpara dhenies se kontrates.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave, bazuar ne nenin 82, te ligjit nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, ku parashikohet se “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*”, ne nenin 26 te VKM-se 285 date 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet se “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*”, konstaton se per permbushjen e ketij kriteri operatoret ekonomike duhet te deklarojne ne Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, te punesuarit si staf mbeshtetes prane tyre.

Nga verifikimi ne SPE i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, te paraqitur nga OE, rezulton se nuk eshe deklaruar emri i te punesuarve si stafin mbeshtetes, duke mos permbushur kete kriter.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe ne në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat

dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “**PEPA GROUP**” **SH.P.K.**, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “**PEPA GROUP**” **SH.P.K.**, *skualifikohet*.

3- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “**SARDO**” SH.P.K me Nuis K13120402W & “**BEQIRI**” SHPK, me Nuis J98624801V, për arsyet e mëposhtme:

Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE rezultoi se OE:

Se pari, nuk plotëson kriterin 1.b të kriterëve të vecanta të kualifikimit ku parashikohet se:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë: *b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave bazuar në nenin 83 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se:

1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërkohë që mund të kërkojë paraqitjen e këtij sigurimi edhe në procedurat nën kufirin e lartë monetar, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, autoriteti ose enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit mundësinë e paraqitjes së sigurimit të ofertës:

i. në formën e garancisë bankare; ose

ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente, nenin 30 të VKM-se 285 date 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet se:

“1 Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, sikurse përcaktohet në nenin 83, të LPP-së.

Enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, sikurse përcaktohet në nenin 83, të LPP-së.

Enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, mund të kërkojë ose jo sigurim oferte për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

2. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës së vlerës së sigurimit, nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, sigurimi i ofertës mund të ketë formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari”, vlerëson se për të përmbushur këto kriter OE-te duhet të paraqesin sigurimin e

ofertës ne formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi e cila duhet të jete e neshkruar nga Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit.

Gjitashtu ne shtocen 3 te DST-se eshte miratuar formulari te cilen duhet te paraqesin operatoret ekonomike pjesmarres ne proceduren e prokurimit per te permbushur kete kriter.

Nga verifikimi ne SPE rezulton se Bashkimi i Operatoreve Ekonomik ka paraqitur nje dokument me shenimin police e sigurimit te ofertes e cila eshte i pa nenshkruar dhe vulosur nga asnje pale.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave thekson se formulari i sigurimit te ofertes qe te jete i vlefshem duhet te nenshkruhet nga Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit.

Se dyti, nuk ploteson kriterin 2.3.6 ne te cilin kerkohe:

Krahas stafit te mesiperm teknik duhet te kete te punesuar staf mbeshtetes edhe:

1 (nje) inxhinier ndertimi

-Per stafin e mesiperm Operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacionin si me poshte: Kontratë pune e vlefshme, Diploma Universitare, Libreze pune si dhe duhet te figuroje ne listëpagesat e shoqerise të paktën për periudhën Qershor 2021 – Gusht 2021

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi fitues perpara dhenies se kontrates.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave, bazuar ne nenin 82 te ligjit nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, ku parashikohet se “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*”, ne nenin 26 te VKM-se 285 date 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet se “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*”, konstaton se per permbushjen e ketij kriteri operatoret ekonomike duhet te deklarojne ne Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, inxhinierin e ndertimit te punesuar si staf mbeshtetes prane tyre.

Nga verifikimi ne SPE i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, te paraqitur nga te dy OE pjese te BOE, rezulton se nuk eshe deklaruar emri i te punesuarit ne stafin mbeshtetes si inxhinier ndertimi, duke mos permbushur kete kriter.

Se treti, nuk ploteson kriterin 2.3.10 ne te cilin kerkohe:

Operatori Ekonomik duhet te disponoje:

a) Liçense me kodin (kodi III.2.B) per transportim te mbetjeve jo te rrezikshme dhe akt miratimin perkates qe perfshin kodin 17 05 04, per dhera dhe gure.

Nga verifikimi ne SPE rezulton se nje nga anetaret e BOE, konkretisht OE Beqiri SHPK ka paraqitur licensen me kod III.2.B per transportin e mbetjeve jo te rrezikshme, por nuk ka paraqitur aktin e miratimit perkates qe perfshin kodin 17 05 04, per dhera dhe gure.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore

përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e **BOE “SARDO” SH.P.K & “BEQIRI” SHPK**, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, **BOE “SARDO” SH.P.K & “BEQIRI” SHPK**, *skualifikohet*.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “LODI CONSTRUCTION” SH.P.K me Nuis L77127002C, me adresë: Rruga Kongresi i Permetit, nr. pasurie 2/1132+1-5, zona kadastrale 8591 me sipërfaqe 80.33 m², Shkoder, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 23,321,720 (njezet e tre million e treqind e njezete nje mije e shtateqind e njezet) lek pa TVSH, është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

KRYETARI
Pjerin NDREU